

STUDIME ETNOGRAFIKE MBI SKËNDERBEUN: 1940-1990

Abstrakt

Ky punim është pjesë e projektit “Bibliografia etnografike mbi Skënderbeun”, e cila shënon një fazë të re në qasjen etnografike, duke përgatitur bibliografi tematike. Kjo bibliografi rendit kontributet rreth figurës së tij në revistat kryesore etnografike, si *Etnografia shqiptare* dhe *Kultura popullore*, por pa lënë mënjanë edhe përzgjedhjen e burimeve të tjera të vlerësuara si etnografikisht të rëndësishme, botuar gjatë viteve 1940-1990. Duke qenë se kjo ishte periudha kur shkenca etnografike shqiptare u krijua, është me interes të shohim mënyrën se si i janë qasur studiuesit figurës së Skënderbeut gjatë kësaj periudhe. Meqenëse kufijtë ndërmjet historisë, arkeologjisë dhe etnologjisë nuk janë gjithmonë të qartë, janë përfshirë studime jo vetëm nga etnologët, por edhe nga studiues të tjerë, kontributet e të cilëve janë të rëndësishme për fushën e etnologjisë.

Fjalë kyçe: Bibliografi, Skënderbeu, Etnografia

Abstract

This article represents a part of the project “The ethnographic bibliography on Scanderbeg”. By presenting a thematic bibliography this project intends to mark a new phase in the ethnographic approach. This bibliography sorts the most important contributions of Scanderbeg from the ethnographic reviews such as *Etnografia Shqiptare* and *Kultura Popullore* including other important ethnographic sources published during 1940-1990. The aim of the bibliography is to investigate how scholars reckoned Scanderbeg during this period considered as the most important years for the creation of the ethnographic science in Albania. This bibliography includes studies not only from ethnographers but scholars from other disciplines as well, whose contributions are to be considered important for the field of ethnology.

Keywords: Bibliography, Skanderbeg, Ethnography

Duke parë se në botime të ndryshme, në revista shkencore, në organe të ndryshme të shtypit të përditshëm e periodik ndodhen të shpërndarë artikuj, studime, materiale e të dhëna të ndryshme të natyrës etnografike për figurën e Skënderbeut, u pa e nevojshme të krijohet një bibliografi e studimeve etnografike mbi figurën e Skënderbeut, që do të ndihmojë për të kuptuar se si i janë qasur etnografikisht figurës së Skënderbeut në periudha të ndryshme, duke u ndalur specifikisht në temat kryesore që janë trajtuar.¹ Në këtë bibliografi do të radhiten të gjithë titujt kryesorë të artikujve, materialeve, studimeve dhe informacioneve etnografike lidhur me këtë figurë, duke u ndalur kryesisht në autorët kryesorë të etnografisë shqiptare.

Mbledhja e të dhënave u realizua përmes tri rrugësh kryesore:

- Së pari, u shqyrtuan të gjithë skedarët e fondit shqip të Bibliotekës Kombëtare në lidhje me veprat që flasin mbi Skënderbeun dhe skedarët e fondit shqip të Arkivit të Institutit të Historisë.
- Së dyti, nga bibliografitë etnografike të botuara u nxorën botimet rreth Skënderbeut.
- Së treti, u shqyrtuan të gjitha bibliografitë e shtypit periodik shqiptar nga viti 1940-1990, të cilat përfshijnë rreth 640 tituj organesh të ndryshme. Të gjitha këto më ndihmuan për të gjurmuar periodikun shqip në lidhje me figurën e heroit.

Duke u përqendruar në fushën specifike që kemi në studim u ndalëm kryesisht në botimet e Sektorit të Etnografisë, disa botime kryesore të Institutit të Historisë dhe, më pas, në artikuj dhe studime me karakter etnografik, ose që përmbajnë të dhëna me interes për etnografinë, të botuara në revistën *Studime historike* dhe në paraardhësin e saj *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës* apo *Buletini i Institutit të Shkencave*, revista *Monumentet*, *Nëntori*, në aktet e sesioneve e konferencave të ndryshme shkencore etj. Gjithashtu nuk janë lënë jashtë artikuj të shtypit të përditshëm e periodik, kronika e informacione të ndryshme nga jeta shkencore në qendër e në rrethe.

¹ Kjo është në kuadër të projektit “Studiues dhe studime”, i cili do të sjellë në vite bibliografi tematike (për tema qendrore që lidhen me fushën e etnografisë) dhe do finalizohet me një punim të studimeve etnografike shqiptare (1980-2007).

Deri tashmë kjo bibliografi përfshin rreth 300 punime të ndryshme, kryesisht të karakterit shkencor, si: artikuj, studime, recensione, por edhe monografi, legjenda etj, botuar rreth heroit gjatë këtyre 50 viteve që janë në shqyrtim, shkruar nga etnologë dhe historianë të ndryshëm.

Nga hulumtimi u pa se qëndrojnë dy grupe kryesore botimesh për Skënderbeun: nga njëra anë janë botimet me karakter të mirëfilltë historik, ku theksohet biografia e heroit në kuadrin e ngjarjeve të epokës së tij apo zbulimi i fakteve historike dhe, nga ana tjetër, qëndrojnë shkrimet që kanë si qëllim thelbësor trajtimin e figurës së Skënderbeut në fusha të ndryshme, përfshirë këtu dhe etnologjinë. Megjithatë në disa raste tiparet dalluese mes shkrimeve nuk janë gjithmonë të qarta, pra ka raste kur në të njëjtin studim bashkohen disa fusha njëherësh, edhe historike, edhe etnologjike.

Gjithsesi, duke parë dhe botimet e këtyre viteve, mund të themi se pas viteve 40' studimet dhe shkrimet mbi Skënderbeun dolën nga kuadri i ngushtë historik duke u trajtuar në një kuadër më të gjerë. Me këtë shpjegohet edhe zgjerimi i fushave që trajtojnë këtë temë, si dhe larmia tipologjike e botimeve në periodikun shqip.

Kështu, nga të dhënat e grumbulluara, evidentohet se deri në vitet '40, figura e Skënderbeut trajtohet etnografikisht në botime përshkrimore në revistat e kohës, si: *Hylli i Dritës*, *Besa*, *Gazeta e Korçës*, *Edukata e re*, *Cirka* etj me autorë: Marin Sirdani, Leo Freundlich, Lef Nosi etj, të cilët trajtojnë përgjithësisht gojëdhëna e legjenda dhe detaje përshkrimore mbi armët dhe përkrenaren e heroit:

- Marin Sirdani. 1926. *Skandërbegu mbas gojëdhanash*, Shkodër.
- Marin Sirdani. 1937. "Ku u vorrue Skëndërbeu?" *Hylli i Dritës*, 7-8: 331-333.
- Leo Freundlich. 1932. "Armët e Skënderbeut, gjanat e shejta të heroit kombëtar" *Besa*, 3-4-5-6-7-8-9: mars.
- Leo Freundlich. 1936. "Armët e Skënderbeut në banimin e ri të muzeumit t'armëve të Vjenës", *Gazeta e Korçës*: 14 mars.
- Shtjefën Gjeçovi. 1914. "Përkrenarja e Skënderbeut", *Hylli i Dritës*, nr.7: 218.
- Gjellaj, F. 1936. "Guri i Skandërbegut dhe mullini me erë

(gojëdhanë)”, *Cirka*, nr. 4: 60-61.

- Lkeni i Hassit. 1905. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Gojëdhanat e popullit t’Kurbinit e t’Kruës”, *Albania, Bruxelles*, 1905, nr.12: 226-227; 1906, nr. 1-2:27-28; nr.4:62-64.
- Pa autor. “Monumenti i Skandërbegut” 1937. *Cirka*, nr. 24:138 dhe 151.
- Lef Nosi. 1918. “Gojdhana popullore e Skënderbeu”, *Kopështi letrar*, nr.1:15-16.
- Thimi Hondro. 1917. “Një përmendore e Skënderbeut”. *Ylli i Mëngjezit*. V. 3 (1): 26-27.
- Marin Sirdani. 1923. “Flamuri kombëtar” (midis të tjerave bëhet fjalë dhe për flamurin e Skënderbeut duke u bazuar në biografët e heroit tonë kombëtar). *Hylli i Dritës*, nr.6:271-276.

Pas viteve ‘40, ndër të gjitha botimet, veçojmë vitin 1967-1968, që përkon me 500-vjetorin e lindjes së Skënderbeut dhe, posaçërisht, me konferencën e dytë të studimeve albanologjike, organizuar më 12-18 janar 1968, e cila kishte temë qendrore: *Figura dhe epoka e Skënderbeut, gjendja e studimeve në këtë fushë dhe detyrat e studimit të mëtejshëm*. Këtu gjejmë rreth 80 kumtesa të ndryshme që janë kryesisht të karakterit historik, por nuk mungojnë dhe ato të karakterit etnologjik. Gjatë këtij viti Institutit të Folklorit i caktohen disa detyra: të botojë një vëllim me tregime e këngë për heroin kombëtar, e cila u realizua nga Qemal Haxhihasani; të organizojë një ekspeditë për kërkime legjendare; punonjësit e institutit të përgatitin 8 kumtesa për çështje të ndryshme lidhur me këtë figurë, gjithashtu edhe angazhimin e 7 punonjësve të jashtëm për të njëjtën arsye. Kështu, nga punonjës të ndryshëm trajtohen në shtyp probleme të ndryshme lidhur me Skënderbeun: për këngët, për tregimet popullore, këngët arbëreshe, për figurën e Skënderbeut në folklor, për kanunin etj. Pra, gama e trajtimit të figurës së tij në këtë vit duket të jetë mjaft e gjerë, duke realizuar kështu gjatë këtij viti shumë botime shkencore kushtuar kësaj figure. Kështu, botimet e para të etnografëve shqiptarë në lidhje me heroin mund të konsiderohen gjatë këtij viti, me kumtesat e mbajtura në konferencën kushtuar 500-vjetorit të lindjes së Skënderbeut dhe me botimet e ndryshme në revistën *Studime historike* dhe shtypin e kohës me autorë, si: Rrok Zojzi,

Pirro Thomo, Kristo Frashëri, Arsen Mustaqi, Dhorka Dhamo, Agron Fico etj.

- Rrok Zojzi. 1969. “Disa aspekte të Kanunit të Skënderbeut parë në kuadrin e përgjithshëm të së drejtës kanunore”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 315-323.
- Andromaqi Gjergji. 1969. “Kontributi i grave në qëndresën e popullit shqiptar kundër pushtuesve osmanë”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 341-346.
- Mark Tirta. 1969. “Skënderbeu në gojëdhënën popullore të Mirditës”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 505-510.
- Dilaver Kurti. 1969. “Mbi prejardhjen e familjes së Skënderbeut”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 620-625.
- Kahreman Ulqini. “Origjina dhe zhvillimi i toponimit “Dukagjin”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 121-126.
- Abaz Dojaka. “Pozita e gruas në familje në zonat malore të vendit tonë”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 171- 176.
- Haxhi Goci. “Besa – virtyt i lartë i popullit shqiptar”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 177-180.
- Qemal Haxhihasani. “Tregimet popullore për periudhën e Skënderbeut”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 481-488.
- Agron Fico. “Probleme të epikës popullore historike dhe figura e Skënderbeut”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 489-496.
- Vangjel Meksi. “Rreth strukturës politike dhe juridike të shtetit të Skënderbeut”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968, vëll. II: 618-619.
- Ismet Elezi. “Karakterit i së drejtës zakonore shqiptare gjatë sundimit turk”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968, vëll. II:165-170.

- Dhosi Liperi. 1969. “Varri dhe shpata e Skënderbeut simbas legjendave popullore”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968, vëll. II: 341-343.
- Arsen Mustaqi. 1969. “Jehona e figurës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut në këngët popullore të luftës nacional-çlirimtare dhe të periudhës së ndërtimit socialist të vendit”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968, vëll. II: 497-504.
- Frano Prendi. 1969. “Vendvarrimi i Skënderbeut”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968, vëll. II: 241-248.
- Sadiku, Hilmi. 1969. “Skënderbeu në gojën e popullit të Dibrës”, në: *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968, vëll. II: 511-516.

Gjatë këtij viti, në kuadër të ekspeditave për kërkime legjendare, numri i botimeve të tilla rritet, duke theksuar mbledhjen e legjendave, gojëdhënave apo tregimeve gojore. Këto botime i gjejmë shpesh të botuara në revista apo shtypin e ditës përgjatë gjithë vitit 1967 dhe vitit 1968, si: *Në shërbim të popullit*, *Luftëtari*, *Bashkimi*, *Mësuesi*, *Vatra e Kulturës*, *Drita*, *Kastrioti*, me autorë, si: Dilaver Kurti, Arsen Mustaqi, Zihni Sako, Naum Prifti, Haxhi Goci, Qemal Haxhihasani, Mark Tirtja, Agron Fico, Vehbi Bala etj. Përmendim disa prej tyre:

- Pa autor. 1967 “Mendime, legjenda dhe kallzime gojore për Skënderbeun”, *Në shërbim të popullit*, nr.1:11.
- Pa autor. 1967. “Heroi ynë legjendar në gojën e popullit”, *Luftëtari*, 13 prill.
- Dilaver Kurti. 1967. “Kastriotët nëpërmjet legjendave”, *Bashkimi*, 7 maj.
- Arsen Mustaqi. 1967. “Ekspedita të përbashkëta me arsimtarë në fshatrat e Krujës”, *Mësuesi*, 12 maj.
- Pa autor. 1967. “Legjenda mbi Skënderbeun”, *Vatra e Kulturës*, nr.5: 39.
- Zihni Sako. 1967. “Figura e Skënderbeut në gojën e popullit”, *Luftëtari*, 16 mars.

- Skënder Anamali. 1967. "Aty ku legjenda përkon me historinë", *Drita*, 9 korrik.
- Pa autor. 1968. "Gojëdhana dhe këngë të popullit për kohën e Skënderbeut", *Drita*, 14 janar.
- Qemal Haxhihasani. 1968. "Jehona e kohës së Skënderbeut në tregimet popullore", *Drita*, 14 janar.
- Qemal Haxhihasani. 1967. "Tregime popullore rreth periudhës së Skënderbeut", *Studime filologjike*, nr.4: 11-29.
- Qemal Haxhihasani. 1967. "Të dhëna bibliografike rreth traditës popullore për Skënderbenë", *Studime filologjike*, nr.4:165-184.
- Thanas Qerama. 1968. "Urimi i kryetrimt (legjendë nga Mati)", *Pioneri*, 10 janar.
- Mark Tirtja. 1967. "Gojëdhana popullore e Mirditës për Skënderbenë", *Studime filologjike*, nr.4: 155-160.
- Qemal Haxhihasani. 1967. "Tregime popullore për Skënderbeun dhe kohën e tij", *Studime filologjike*, nr.3: 167-195.
- Qemal Haxhihasani. *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbenë*, Tiranë: Instituti i Folklorit.
- Vehbi Bala. 1967. "Fytyra e GJKS nëpër gojëdhana dhe këngë historike të popullit tonë". *Shkodra*, nr. 1(7): 11-21.
- Agron Fico. 1967. "Vëzhgime rreth disa legjendave për Skënderbeun të mbledhura në Zaranikë", *Studime filologjike*, nr.3: 191-195.
- Gjergj Zheji. 1967 "Skënderbeu në legjendat krutane", *Kruja e Skënderbeut*: 61-65.

Duke vazhduar më tej shohim se një pjesë e veçantë e këtyre botimeve i është kushtuar ekspeditave që u ndërmorën për 500-vjetorin e Skënderbeut dhe, veçanërisht, mbledhjes së Kanunit të Skënderbeut. Këto ekspedita realizoheshin nga dy studiuesit e Sektorit të Etnografisë, Rrok Zojzi dhe Andromaqi Gjergji. Të dhëna me interes në këtë fushë vijnë edhe nga studiues të tjerë, si: Kahreman Ulqini, historiani Kristo Frashëri me botime në konferencën e parë të studimeve etnografike më 1976, studiuesi Haxhi Goci në revistën *Etnografia shqiptare* të 1987-s, Vangjel Mexsi etj.

- Rrok Zojzi. 1967. "Aspekte të kanunit të Skënderbeut të parë në kuadrin e përgjithshëm të së drejtës kanunore", *Studime historike*, nr. 4: 173-181.
- Kristo Frashëri. 1976. "Mbi kanunin e Skënderbeut", në: *Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike*, 28-30 qershor 1976: 231-244.
- Rrok Zojzi dhe Andromaqi Gjergji. 1952. *Raport etnografik mbi Kanunin e Skënderbeut*, Tiranë: Instituti i Historisë.
- Kristo Frashëri. 1977. "Mbi Kanunin e Skënderbeut", *Studime historike*, nr. 2:125-143.
- Kahreman Ulqini. 1961. "Gjurmime etnografike në trojet e Skënderbeut", *Buletini i Universitetit të Tiranës, seria shkencat shoqërore*, nr. 2:162-195.
- Kahreman Ulqini. 1961. "Dy vërejtje rreth Kanunit të Lekë Dukagjinit, mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi", Shkodër.
- Kahreman Ulqini. 1974. "Tema dhe emërtime në Kanunin e Skënderbeut dhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit", *Kumtari i muzeut Popullor të Shkodrës*, nr.2: 112-159.
- Rrok Zojzi. 1969. "Disa aspekte të Kanunit të Skënderbeut, të para në kuadrin e përgjithshëm të së drejtës kanunore". Në *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*: 315-323.
- Kristo Frashëri. 1977. "Mbi Kanunin e Skënderbeut", *Drita*, 3 tetor.
- Vangjel Meksi. 1967. "Kanuni i Skënderbeut dhe kanuni i Lekë Dukagjinit, momente historike me vlerë të së drejtës shqiptare", *Drejtësia popullore*, nr.4: 52-53.
- Vangjel Meksi. 1967. "Të dhëna rreth institucioneve shtetërore dhe juridike të shtetit të Skënderbeut", *Puna*, 14 mars.
- Vangjel Meksi. 1969. "Rreth strukturës politike dhe juridike të shtetit të Skënderbeut". Në *Konferenca II e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 12-18 janar 1968: 618-619.
- Haxhi Goci. 1986 "Një vështrim historik mbi kanunin e Skënderbeut", *Kastrioti*, 28 shkurt: 6.
- Haxhi Goci. 1987. "Vështrim historik mbi kanunin e Skënderbeut", *Etnografia shqiptare*, nr.15: 87-98.

Në vitet që pasojnë, gama e studimeve rreth figurës së Skënderbeut vjen duke u zgjeruar. Fushat e trajtimit të kësaj figure bëhen më të gjera dhe nuk mbeten vetëm në kuadër të trajtimit historik. Ato krijojnë tematika për trajtimin e figurës së heroit në artin figurativ, artin popullor, në monumente, muze ku përshkruhen buste, portrete, kompozime etj, me mjaft interes në fushën e etnografisë.

Në artin figurativ dhe artin popullor, figura e heroit, ndër të tjera, trajtohet në qëndistari, argjendari e deri në punime të avlëmendit. Këtu përmendim:

- Dhorka Dhamo. 1968. "Skënderbeu në artet tona figurative", *Ylli*, nr.1:11.
- Taulant Gjergji. 1978. "Një portret i Skënderbeut në dru", *Adriatiku*, 8 janar.
- Skënder Lila. 1981. "Një portret në mëndafsh i Skënderbeut (të njohim traditat tona patriotike)". *Adriatiku*, 18 janar.
- Moikom Zeqo. 1985. "Figura e Skënderbeut në artet figurative", *Zëri i popullit*, 1985, 10 janar.
- Moikom Zeqo. 1985. "Vepra arti me figurën e Skënderbeut", *Në shërbim të popullit*, nr.1:16.
- Moikom Zeqo. 1983. "Skënderbeu në pikturën shqiptare të traditës", *Zëri i popullit*, 28 prill.
- Ulqini, Hasan. 1982. "Një portret i Skënderbeut. Portret i gdhendur me dru, autor i tij mendohet se mund të jetë Kolë Idromeno", *Bashkimi*, 31 tetor.

Një tjetër hapësirë në botimet rreth Skënderbeut zënë edhe shkrimet për monumentin e tij, vendimet për monumentet e ndryshme të kësaj figure, skulptorët që e realizuan, takimet që ata bënë me punonjësit e Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, të cilët treguan për punën që është bërë për vendosjen e monumenteve të ndryshme, idetë që i kanë frymëzuar skulptorët dhe vështirësitë që kanë hasur. Po listojmë disa të tilla:

- Pandi Mele. 1985. "Monumenti i Skënderbeut në Krujë. Vepër e skulptorit të popullit Janaq Paco", *Drita*, 24 mars: 5.

- Hasan Ulqini. 1985. “Monumentin e heroit e ngriti populli dhe Partia. Përpjekjet e atdhetarëve shqiptarë për figurën e Skënderbeut. Patrioti Murat Toptani gdhendi skulpturën e parë të Skënderbeut në vitin 1898. Skulptura e dytë nga skulptori shqiptar Thimi Hondro. Monumentet e Skënderbeut në vitet e Partisë”, *Zëri i popullit*, 30 maj.
- Latif Latimi. 1984. “Përkujtimorja e Skënderbeut te Kisha e Shënkollit në Lezhë, restaurimi i saj në përmendore sot”, *Monumentet*, nr. 2:57-76.
- Pa autor. 1968. “Monumenti i Skënderbeut, një krijim me dinjitet artistik”, *Zëri i popullit*, 19 janar.
- Andon Kuçali. 1983. “Monumenti i Skënderbeut në Krujë. Monumente të artit dhe të kulturës”, *Zëri i popullit*, 1 mars.

Gjithashtu shumë botime gjejmë rreth krijimit dhe organizimit të ekspozitave të ndryshme, ku përshkruhen jo vetëm ambiente ekspozimi të veçanta, por edhe muze kushtuar figurës së Skënderbeut. I shoh me interes nga ana etnografike momentet përshkruese të objekteve të veçanta si pjesë e këtyre ekspozitave. Në këto veçojmë:

- Kasem Biçoku. 1977. “Armët e Heroit tonë kombëtar (me rastin e përvjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut)”, *Kastrioti*, 14 janar.
- Pranvera Hoxha dhe Piro Vaso. 1978. “Muzeu i Skënderbeut në Krujë”, *Shkenca dhe jeta*, nr. 4:30-33.
- Pranvera Hoxha dhe Piro Vaso. 1978. “Kështu do të jetë muzeu kushtuar Gjergj Kastriotit – Skënderbeut”, *Shqipëria e re*, nr. 5: 22-23.
- Ramadan Sokoli. 1979. “Shpatat e Skënderbeut”, *Ylli*, nr.1: 30-31.
- Kristo Frashëri. “Flamuri i Skënderbeut”, *Drita*, 31 dhjetor.
- Pa autor. 1983. “Armët dhe përkrenarja e Skënderbeut. Dy shpata dhe përkrenarja ndodhen në Muzeun e Vjenës”, *Shqipëria e re*, nr.4:6.
- Pranvera Hoxha. 1983. “Muzeu Kombëtar ‘Gjergj Kastrioti Skënderbeu në Krujë’”, *Shkenca dhe jeta*, nr.1:29-33.
- Liri Shehu, Mimoza Kroi dhe Genc Daiu. 1983. “Muzeu i Skënderbeut në Krujë, një nga arritjet më të mira të arkitekturës sonë socialiste”, *Ndërtuesi*, nr.1:17-19.
- Kasem Biçoku. 1977. “Armët e Heroit tonë kombëtar”, *Kastrioti*, 14

janar.

- Kasem Biçoku. 1983. “Shqiponja dykrenore e Skënderbeut, simbol i lirisë (nëpër stendat dhe vitrinat e Muzeut Kombëtar GJKS)”, *Kastrioti*, 14 tetor.
- Kleanth Dedi. 1982. “Mbi armët dhe përkrenaren e Skënderbeut”, *Ylli*, 1982, nr. 9: 30-31.
- Binard Bilota. 1967. “*Shpata e Skënderbeut ndër Dibrët poshtë*”. Redaktuar, pajisur me shënime dhe me hyrje nga P. Emanuil Jordani. Tiranë: Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë.

Në lidhje me sa parashtruam më lart, vërejmë se studimet etnografike rreth figurës së Skënderbeut nuk janë të pakta. Fushat e trajtimit duken mjaft të gjera duke na vështirësuar dhe përzgjedhjen në studimet etnografike. Po të shikojmë studimet që janë bërë gjatë këtyre viteve që kemi në trajtim, mund të arrijmë në përfundimin se figura e Skënderbeut del nga rrethi i ngushtë i studimeve historike, duke u trajtuar më pas në të gjitha fushat shoqërore. Për sa i përket etnografisë vërehet se botimet më të shumta vijnë pas viteve ‘60 me organizimin e konferencës kushtuar 500-vjetorit të lindjes të Skënderbeut, duke sjellë dhe një larmi tipologjike të botimeve.

Megjithatë është për t’u theksuar që ky punim vjen me një bibliografi të përzgjedhur për t’i lënë mundësi botimit të plotë të kësaj bibliografie në të ardhmen, ku mendohet të vijohet me fazën e dytë të këtij projekti, vitet 1991-2018, duke bërë të mundur dhe përfshirjen e këtij viti jubile për të ndihmuar në këtë mënyrë studiuesit të shohin se si i janë qasur etnografikisht figurës së Skënderbeut në periudha të ndryshme.

